

AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 21.6.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË AKTIN NORMATIV NR. 1, DATË 20.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)”, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 23/2019

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aktin normativ nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr. 23/2019, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, togfjalëshi “... 2 (dy) ...” zëvendësohet me “... 3 (tre) ...”.

Neni 2

Në nenin 2, fjalët “... kryeqytet i Republikës së Sudanit të Jugut.”, zëvendësohen me “... si dhe në Shtabin e Komandës Bor, Jonglei, në Sudanin e Jugut.”

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku